

Nga individit te zinxhirit i përgjegjës

Monitorimi i integritetit institucional, prill–gusht 2026



Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke realizuar projektin “Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy). Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë përgjegjësi e ISP-së.

@Instituti i Studimeve Politike

Tiranë, Gusht 2026

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: www.isp.com.al

E-mail: contactaips@isp.com.al

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

Executive Summary	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	5
Metodologjia	6
I. HYRJE	7
II. VENDIMMARRJA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË	8
Pasqyra e përgjithshme	8
Rasti A.K. — cikli i plotë i kontrollit gjyqësor mbi refuzimin e kërkesës për procedim disiplinor	8
Kontrolli gjyqësor si korrektiv i filtrit disiplinor	9
Rikalibrimi i treguesit të efektivitetit	9
Vlerësim përmbledhës	9
III. VENDIMMARRJA E SPAK-UT	10
Pasqyra e përgjithshme	10
Analiza sipas veprës penale	11
Analiza sipas kategorisë së subjektit dhe shpërndarjes gjeografike	11
Çështja ARRSH – Bashkia Kolonjë	12
Sekuestrimi i pasurive — çështja e AKSHI-t	13
Cikli i plotë procedural: rasti I.H.	13
Vlerësim përmbledhës	14
IV. VENDIMMARRJA E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT	14
Ndryshimi i natyrës së veprimtarisë	14
Transparenca e dispozitivit dhe vonesa e publikimit	14
Mendimet paralele dhe mendimi i pakicës	15
Analiza juridike e institutit të rishikimit	15
V. GJETJET KRYESORE	16
VI. KONKLUSIONE	17
VII. REKOMANDIME	17

Executive Summary

This report continues the monitoring of institutional mechanisms for safeguarding public integrity and accountability within Albania's justice system, focusing on the activities of the High Justice Inspector (HJI), the Special Structure against Corruption and Organised Crime (SPAK), and the Special Appeal Chamber (KPA) during April–July 2026, with supplementary data through 19 August 2026. Comparison with the October 2025–March 2026 monitoring period is based on average monthly intensity, allowing for a more accurate assessment of changes between periods.

Overall, the volume of monitored acts decreased by 18.0% in terms of average monthly intensity. However, this decline should not automatically be interpreted as a weakening of institutional activity. The monitoring identifies significant delays in the publication of decisions, changes in the nature of institutional activity, and the concentration of cases within complex investigations. The period therefore reflects primarily a qualitative shift in the model of oversight and accountability, rather than a general slowdown in institutional performance.

SPAK maintained the most stable operational profile, with an intensity decrease of only 5.5%, while the share of subjects sent for trial increased from 83.3% to 94.7%. The main development is a shift from individual corruption cases towards investigations targeting administrative mechanisms and chains of responsibility, particularly in public procurement. A single case accounted for 78.9% of all subjects recorded during the period and revealed a coordinated model of responsibility extending from management level to procurement units and supporting documentation. In parallel, the seizure of assets worth more than EUR 40 million in a case involving public procurement in the information technology sector illustrates the increasing importance of asset-based measures in anti-corruption enforcement.

For the High Justice Inspector (HJI), the most significant development concerns the completion of the disciplinary cycle in the A.K. case, where a request initially rejected by the relevant Council was ultimately accepted following judicial review by the Administrative Court of Appeal. The case demonstrates the functioning of judicial review as an effective corrective mechanism within the disciplinary system and increases the share of HJI proposals that resulted, fully or partially, in disciplinary measures from 33.3% to 66.7%. At the same time, the 294-day period between the initial rejection and the final acceptance highlights the need to reduce procedural delays.

The activity of the Special Appeal Chamber (KPA) has changed substantially in nature. All 23 monitored decisions concerned requests for review of the Chamber's own final decisions, indicating that the ordinary appellate phase of the transitional re-evaluation process is effectively nearing completion. At the same time, 82.6% of the decisions were accompanied by concurring opinions, suggesting that the jurisprudence concerning the review mechanism is still being consolidated. The report also identifies a significant transparency issue: 22 of the 23 decisions were published approximately two to three months after they were issued, while only 8.7% had an outcome that could be verified without individually reviewing the full decision.

Overall, monitoring indicates that institutional oversight mechanisms remain operational and are moving towards more complex forms of accountability. The main areas requiring improvement are the reduction of delays in the publication of SAC decisions, the introduction of a standardised summary of the operative part of each decision, and the shortening of the disciplinary cycle involving the HJI, the Councils and judicial review.

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport vijon monitorimin e mekanizmave institucionalë të kontrollit mbi integritetin publik dhe sistemin e drejtësisë në Shqipëri, duke analizuar veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) gjatë periudhës prill–korrik 2026, me të dhëna plotësuese deri më 19 gusht 2026. Krahasimi me periudhën tetor 2025–mars 2026 është realizuar mbi bazën e intensitetit mesatar mujor, duke mundësuar një vlerësim më të saktë të ndryshimeve ndërmjet periudhave.

Në tërësi, volumi i akteve të monitoruara rezulton 18% më i ulët në terma të intensitetit mesatar mujor. Megjithatë, kjo rënie nuk duhet interpretuar automatikisht si dobësim i aktivitetit institucional. Monitorimi evidenton vonesa të konsiderueshme në publikimin e akteve, ndryshime në natyrën e veprimtarisë së institucioneve dhe përqendrimin e rasteve në hetime komplekse, duke treguar se gjatë kësaj periudhe ka ndodhur më shumë një ndryshim cilësor i modelit të kontrollit dhe llogaridhënies sesa një ngadalësim i përgjithshëm.

SPAK ruan profilin më të qëndrueshëm, me një rënie të intensitetit prej vetëm 5,5% dhe me rritje të pjesës së subjekteve të dërguar për gjykim nga 83,3% në 94,7%. Gjetja kryesore lidhet me zhvendosjen e fokusit nga rastet individuale të korrupsionit drejt hetimit të mekanizmave administrativë dhe zinxhirëve të përgjegjësisë, veçanërisht në prokurimet publike. Një çështje e vetme përfshiu 78,9% të subjekteve të periudhës dhe evidentoi një model të koordinuar përgjegjësie që shtrihet nga niveli drejtues te njësitë e prokurimit dhe dokumentacioni mbështetës. Paralelisht, sekuestrimi i pasurive me vlerë mbi 40 milionë euro në një çështje të lidhur me prokurimet në sektorin e teknologjisë së informacionit tregon rritjen e rëndësisë së instrumenteve pasurore në luftën kundër korrupsionit.

Për ILD-në, zhvillimi më domethënës është përfundimi i ciklit disiplinor në rastin A.K., ku një kërkesë fillimisht e rrëzuar nga Këshilli u pranua pas kontrollit të Gjykatës Administrative të Apelit. Rasti demonstroi funksionimin e mekanizmit të kontrollit gjyqësor si korrektiv të vendimmarrjes disiplinore dhe rrit shkallën e propozimeve të ILD-së që kanë prodhuar masa disiplinore, plotësisht ose pjesërisht, nga 33,3% në 66,7%. Megjithatë, kohëzgjatja prej 294 ditësh nga refuzimi fillestar deri te pranimi përfundimtar evidenton nevojën për reduktimin e afateve procedurale.

Veprimtaria e KPA-së ka ndryshuar natyrë. Të 23 vendimet e monitoruara lidhen me kërkesa për rishikimin e vendimeve të formës së prerë, duke treguar se faza e zakonshme e apelit të procesit të rivlerësimit kalimtar është praktikisht drejt përfundimit. Në të njëjtën kohë, 82,6% e vendimeve shoqërohen me mendime paralele, çka tregon se praktika mbi institutin e rishikimit është ende në proces konsolidimi. Raporti evidenton gjithashtu një problem të rëndësishëm transparence: 22 nga 23 vendimet janë publikuar me vonesë prej rreth dy deri në tre muaj, ndërsa vetëm 8,7% e tyre kanë një rezultat që mund të verifikohet pa leximin e plotë të aktit.

Në përfundim, monitorimi tregon se mekanizmat e kontrollit institucional vazhdojnë të funksionojnë dhe po kalojnë drejt formave më komplekse të llogaridhënies. Prioritetet kryesore për përmirësim mbeten: reduktimi i vonesave në publikimin e vendimeve të KPA-së; publikimi i një dispozitivi të standardizuar për çdo vendim dhe shkurtimi i ciklit të procedimeve disiplinore ndërmjet ILD-së, Këshillave dhe kontrollit gjyqësor.

Metodologjia

Raporti mbështetet në një qasje të integruar analitike, që kombinon analizën sasiore me interpretimin juridik të të dhënave të mbledhura për institucionet e monitoruara. Analiza synon të evidentojë jo vetëm shpërndarjen statistikore të rasteve, por edhe kualifikimin juridik të tyre, standardin e kontrollit që rezultojnë nga praktika institucionale dhe efektin e vendimmarrjes mbi integritetin publik. Në krahasim me raportin paraardhës, metodologjia është pasuruar me tre elemente të reja: (i) standartizimin kohor të treguesve, që lejon krahasim korrekt midis periudhave me gjatësi të ndryshme; (ii) matjen e ciklit të plotë procedural për rastet që kalojnë nga një periudhë monitorimi te tjetra; dhe (iii) matjen e vonës së publikimit si tregues autonom i transparencës institucionale.

Të dhënat janë mbledhur nga burime zyrtare dhe publike institucionale: njoftimet e ILD-së për procedimet disiplinore dhe vendimet e Këshillave; vendimet e publikuara (të anonimizuara¹) dhe njoftimet e KPA-së; si dhe njoftimet për shtyp të SPAK-ut. Çdo e dhënë është regjistruar me lidhjen përkatëse të akti burimor e reflektuar në databazë çka mundëson gjurmimin dhe verifikimin e plotë të secilit rast.

Periudha e mëparshme e monitorimit (1 tetor 2025 – 31 mars 2026) përfshin 182 ditë; periudha bazë e këtij raporti (1 prill – 31 korrik 2026) përfshin 122 ditë; ndërsa periudha e zgjeruar me të dhënat e gushtit (1 prill – 19 gusht 2026) përfshin 141 ditë. Meqenëse krahasimi i numrave absolutë midis periudhave me gjatësi të ndryshme prodhon rezultate jo të sakta, të gjitha krahasimet ndërperiudhë në këtë raport janë bërë mbi bazën e intensitetit mesatar mujor, i llogaritur sipas formulës: numri i rasteve ÷ numri i ditëve të periudhës × 30,44 (gjatësia mesatare e muajit). Përqindjet janë rrumbullakuar në një shifër pas presjes dhjetore; për këtë arsye, në disa tabela shuma e tyre mund të devijojë nga 100% me ±0,1 pikë përqindjeje.

Kufizimet në metodologji

Për KPA-në, 21 nga 23 vendimet e monitoruara janë të disponueshme vetëm si akt i plotë i publikuar, në formatin PDF të anonimizuar, pa një njoftim të veçantë që të konfirmojë dispozitivin. Kjo do të thotë se rezultati përfundimtar i tyre nuk mund të verifikohet me metoda të monitorimit të strukturuar dhe kërkon lexim individual të secilit vendim.

Së dyti, dhe më e rëndësishmja për interpretimin e gjetjeve, kjo periudhë ka vërtetuar ekzistencën e një vonese sistematike të publikimit. Njëzet e dy vendime të KPA-së të datave 10–24 mars 2026 janë bërë publike vetëm në maj–qershor 2026, pra me një vonesë prej rreth dy deri në tre muaj. Për rrjedhojë, çdo matje e volumnit të veprimtarisë institucionale në fund të një periudhe monitorimi është strukturalisht e nënvlerësuar, dhe rënia e regjistruar për periudhën prill – gusht 2026 duhet kuptuar si kufi i sipërm i rënies reale.

Së treti, raporti mbulon një periudhë të kufizuar kohore. Disa prej çështjeve të përfshira mund të kenë pësuar zhvillime të mëtejshme pas datës 19 gusht 2026, të cilat nuk janë reflektuar në këtë analizë.

¹ Në përputhje me parimin e prezumimit të pafajësisë (*neni 30 i Kushtetutës dhe neni 4 i Kodit të Procedurës Penale*), subjektet ndaj të cilëve ka nisur ndjekje penale ose procedim disiplinor identifikohen në tekstin analitik vetëm me inicialet e tyre, edhe kur burimi zyrtar i ka publikuar emrat e plotë.

I. HYRJE

Ky raport është vazhdim i drejtpërdrejtë i raportit analitik për periudhën tetor 2025 – mars 2026 dhe mbulon periudhën prill – korrik 2026, me të dhëna plotësuese për muajin gusht deri më datë 19 gusht 2026. Ai ruan të njëjtin objekt monitorimi, të njëjtën strukturë analitike dhe të njëjtin grup burimesh institucionale: Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), me qëllim që të dyja periudhat të jenë plotësisht të krahasueshme dhe seria e monitorimit të ndërtohet si vazhdimësi metodologjike, jo si një bashkësi raportesh të veçuara.

Të dhënat e monitorimit të grumbulluara në harkun kohor tetor 25- korrik 26 ndërtojnë një panoramë të gjendjes institucionale, qe lejon leximin e ndryshimeve. Si raste konkrete që evidentohet ndryshimi gjatë monitorimit mund të veçojmë 1) procedimi disiplinor i ILD-së ndaj një prokurore, i regjistruar në monitorimin e mëparshëm si i rrëzuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe që gjatë kësaj periudhe përfundoi me pranim të kërkesës, pas ndërhyrjes korrigjuese të gjykatës administrative të apelit; 2) çështja penale ndaj një ish oficeri të policisë gjyqësore, e cila brenda horizontit kohor të dy raporteve kaloi të gjitha fazat, nga masa e sigurisë “arrest në burg” te vendimi dënues i shkallës së parë. Të dy rastet tregojnë se monitorimi i vazhdueshëm është i nevojshëm dhe mundëson analizë dhe vlerësim të plotë të gjendjes institucionale sepse kuptimi juridik i një akti shpesh formohet vetëm në ciklin pasues.

Institucionet e përfshira nuk veprojnë në të njëjtin nivel kompetencash: KPA, ILD ushtrojnë funksione juridiksionale ose disiplinore ndërsa SPAK ushtron funksione hetimore dhe ndjekjeje penale. Megjithatë, të gjitha kontribuojnë në një bosht të përbashkët funksional: kontrollin mbi integritetin dhe mbi ushtrimin e funksionit publik.

Gjatë periudhës bazë prill – korrik 2026, intensiteti mesatar mujor shënon rënie që shkon nga 5,5% te SPAK deri në 50,3% te ILD, por, çdo lexim i periudhës si “ngadalësim i përgjithshëm i aktivitetit institucional” do ishte i pasaktë. Ajo që ndodh është një rikonfigurim: pesha e vendimmarrjes zhvendoset nga organet juridiksionale e hetimore drejt organit përfaqësues, i cili gjatë kësaj periudhe zhvilloi procedurat më voluminoze të plotësisht të organeve të pavarura të gjithë serisë së monitorimit.

Analiza e të dhënave sugjeron se rezultati i përgjithshëm është mbivendosje e të paktën tre faktorëve të ndryshëm, secili me peshë të ndryshme te secili institucion.

1. **Vonesa e publikimit.** Siç u konstatua më sipër 22 vendime të KPA-së të marra në mars 2026 janë publikuar vetëm në maj–qershor 2026. Nëse e njëjta vonesë vlen edhe për periudhën aktuale, një pjesë e akteve të korrikut dhe gushtit 2026 nuk ishte ende publike në momentin e mbylljes së monitorimit. Ky faktor prek në mënyrë asimetrike fundin e periudhës dhe prodhon një nënvlerësim strukturor.
2. **Shterimi strukturor i disa kategorive.** Te KPA, mbyllja e fazës së zakonshme të apelit të procesit të rivlerësimit kalimtar çon në rënie të pashmangshme të vendimeve substanciale, e cila shpjegon plotësisht rënien prej 36,5%.
3. **Përqendrimi i veprimtarisë në operacione të mëdha.** Te SPAK, 15 nga 19 subjektet e periudhës (78,9%) burojnë nga një çështje e vetme. Kjo do të thotë se numri i subjekteve nuk mat “sasinë e punës”, por rezultatin e përfundimit të hetimeve komplekse, të cilat maturojnë në grupe. Pikërisht kjo veçori shpjegon pse SPAK-u është i vetmi institucion pa rënie domethënëse: një çështje e vetme e madhe mjafton për ta mbajtur volumin në nivelin e periudhës së mëparshme.

II. VENDIMMARRJA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Pasqyra e përgjithshme

Gjatë periudhës prill – korrik 2026, monitorimi regjistron një akt të vetëm në lidhje me veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 23.07.2026, me të cilin u pranua kërkesa e ILD-së për procedim disiplinor ndaj një prokuroreje (A.K.). Në numër absolut, kjo është vendimarrja më e ulët e të gjithë institucioneve të monitoruara. Në peshë juridike, ajo është ndër më të rëndësishmet e gjithë raportit, sepse mbyll një cikël të nisur në periudhën e mëparshme dhe përmbys një prej konkluzioneve të saj.

Konteksti duhet kujtuar. Në monitorimin e periudhës tetor 2025 – mars 2026 u regjistruan tri propozime disiplinore të ILD-së: dy të rrëzuara nga KLP (rastet A.K. dhe B.S.) dhe një e pranuar pjesërisht nga KLGj (rasti Sh.L.). Monitorimi i vazhdueshëm evidenton se Vendimi i datës 23.07.2026 ndryshon konkluzionin qw “asnjë prej propozimeve nuk u pranua plotësisht”.

Rasti A.K. — cikli i plotë i kontrollit gjyqësor mbi refuzimin e kërkesës për procedim disiplinor

Shkeljet e konstatuara, sipas njoftimit publik të ILD-së, mbështeten në nenin 102/1, shkronjat “g” dhe “j”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe konsistojnë në dy sjellje të dallueshme: nënshkrimin e shkresave pa pasur kompetencën përkatëse dhe nxjerrjen e dërgimit të persona të tretë të kopjeve të akteve të një dosjeje ende në fazën e hetimit. Pasojat e evidentuara janë anashkalimi i autoritetit të drejtuesit të prokurorisë, cenimi i imazhit institucional dhe rreziku për mbarëvajtjen e hetimit.

Data	Akti	Efekti juridik
02.10.2025	KLP rrëzon kërkesën e ILD-së për masën “vërejtje publike”	Procedimi disiplinor mbyllet në nivel Këshilli
—	ILD ushtron padi në Gjykatën Administrative të Apelit	Aktivizohet kontrolli gjyqësor mbi aktin e Këshillit
—	Gjykata Administrative e Apelit pranon padinë e ILD-së	Çështja i kthehet KLP-së për rishqyrtim
23.07.2026	KLP pranon kërkesën e ILD-së për procedim disiplinor	Vendimi i mëparshëm i rrëzimit zëvendësohet
294 ditë	Kohëzgjatja e ciklit të plotë	Nga refuzimi të pranimit përfundimtar

Tabela 1_Kronologjia e rastit A.K.

Nga analiza konstatojmë se, nënshkrimi i shkresave pa kompetencë prek rendin e brendshëm të kompetencave dhe parimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organit; është, në thelb, një shkelje e strukturës hierarkike dhe funksionale të prokurorisë. Nxjerrja e akteve të një dosjeje në hetim prek sekretin hetimor dhe efektivitetin e hetimit, pra një të mirë juridike me natyrë funksionale dhe me rrezik konkret dëmtimi. Kumulimi i të dyjave ndërton një kualifikim që nuk mund të reduktohet në thjesht “sjellje jokorrekte”: ai përshkruan një cenim të njëkohshëm të organizimit të brendshëm dhe të konfidencialitetit të procedimit.

Kontrolli gjyqësor si korrektiv i filtrit disiplinor

Vlera sistemike e këtij rasti nuk qëndron te masa e propozuar “*vërejtja publike*”, është masa më e butë në shkallën disiplinore, por te rruga që ndoqi çështja. Për herë të parë brenda ciklit të monitorimit, dokumentohet cikli i plotë: propozim i ILD-së → rrëzim nga Këshilli → ankim gjyqësor i ILD-së → pranim i padisë nga gjykata administrative → rishqyrtim i detyruar → pranim përfundimtar i propozimit.

Ky cikël dëshmon disa gjëra njëherësh.

1. **Refuzimi i një propozimi për masë disiplinore nuk është akt përfundimtar.** Vendimet e Këshillave për rrëzimin e kërkesave të ILD-së i nënshtrohen kontrollit gjyqësor administrativ. Kjo do të thotë se raporti midis ILD-së dhe Këshillave nuk është raport varësie ku fjala e fundit i takon organit vendimmarrës, por raport i mbikëqyrur nga gjykata.
2. **ILD ka legjitimitet aktiv procedural.** Fakti që gjykata pranoi padinë e ILD-së konfirmon se inspektori vepron jo thjesht si organ propozues, por si palë me interes të mbrojtur ligjërisht në rezultatin e procedimit disiplinor. Ky është element thelbësor për pavarësinë funksionale të institucionit.
3. **Standardi i pragut disiplinor është i kontrollueshëm.** Në raportin e mëparshëm u ngrit hipoteza e një “*diference të mundshme në vlerësimin e pragut të shkeljes disiplinore*” midis ILD-së dhe Këshillave. Rasti A.K. e konfirmon këtë hipotezë dhe njëkohësisht tregon se diferenca nuk mbetet e pazgjidhur: ajo i nënshtrohet një “*arbitri të tretë*”, gjykatës administrative, e cila në këtë rast qëndroi me vlerësimin e ILD-së.

Çmimi i këtij korigjimi është koha. Nga refuzimi fillestar te pranimi përfundimtar kaluan 294 ditë, pra rreth nëntë muaj e njëzet ditë, për një procedim që kërkonte masën më të butë disiplinore të parashikuar nga ligji. Ky raport kohëzgjatje-masë ngre një çështje proporcionaliteti procedural: kur mjeti korigjues kërkon dhjetë muaj për të prodhuar një vërejtje publike, efekti parandalues i sistemit disiplinor dobësohet ndjeshëm. Nga pikëpamja e nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kohëzgjatja prek edhe interesin e vetë magjistratit të hetuar, i cili qëndron nën procedim disiplinor për një periudhë të zgjatur.

Rikalibrimi i treguesit të efektivitetit

Zhvillimi i 23 korrikut 2026 imponon një rishikim të treguesit të efektivitetit të ILD-së të evidentuar në periudhën e mëparshme të monitorimit. Nga tri propozimet e regjistruara në serinë e monitorimit, një është pranuar plotësisht, një pjesërisht dhe një mbetet i rrëzuar. Shkalla e propozimeve që kanë prodhuar një masë disiplinore, plotësisht ose pjesërisht, kalon nga 33,3% në 66,7%. Kjo gjetje ka një vlerë metodologjike që tejkalon rastin konkret. Ajo tregon se treguesit e efektivitetit të një organi propozues nuk mund të maten brenda kufijve kohorë të një periudhe të vetme monitorimi. Rezultati i një propozimi disiplinor formohet përgjatë një cikli që përfshin edhe fazën e kontrollit gjyqësor, e cila mund të zgjasë edhe dhjetë muaj.

Vlerësim përmblledhës

Me një akt të vetëm, ILD-ja prodhoi gjetjen më domethënëse institucionale të periudhës. Roli i saj konfirmohet si hallkë hetimore dhe nxitëse e llogaridhënies, ndërsa vendimmarrja disiplinore mbetet kompetencë e Këshillave. Mbetet, megjithatë, një vërejtje në planin sasior. Tri propozime disiplinore në një periudhë monitorimi prej dhjetë muajsh e gjysmë, për një sistem drejtësie me qindra magjistratë,

është një volum i ulët. Kjo shifër, e lexuar e vetme, mund të krijojë përshtypjen se ILD-ja është pasive ose se aksesit drejt saj është i kufizuar.

Ka, megjithatë, arsye se pse numri i propozimeve formale mund të mos jetë treguesi i duhur i veprimtarisë së institucionit. Procedimi disiplinor prek drejtpërdrejt pavarësinë e gjyqtarit ose të prokurorit, dhe standardi i provës që ILD duhet të plotësojë përpara se t'i drejtohet Këshillave nuk është i ulët, siç e tregoi edhe rasti i trajtuar më sipër, ku vetë Këshilli fillimisht nuk u bind. Një institucion që filtron me kujdes, që mbyll me arkivim ankesat dhe që përdor procedimin disiplinor si mjet të fundit, jo të parë, mund të prodhojë pak propozime pikërisht sepse po funksionon si duhet, dhe jo sepse është joefektiv. E kundërta, një ILD që nis procedime disiplinore me shumicë, do të rrezikonte vetë të kthehej në instrument presioni mbi gjyqësorin, çka do të ishte problem më i rëndë se ai i një volumi të ulët.

Webfaqja e ILD-së mban një numërues që përditësohet çdo të hënë me ankesat e konfirmuara, të trajtuara, në proces shqyrtimi e verifikimi, magjistratët e hetuar dhe kërkesat për procedim disiplinor. Në fillim të gushtit 2026, numëruesi shënonte afër 9.500 ankesa të konfirmuara që nga fillimi i veprimtarisë institucionale, prej të cilave rreth 7.100 ishin trajtuar plotësisht, dhe vetëm 58 kishin çuar në kërkesë për procedim disiplinor. Ky raport; disa mijëra ankesa kundrejt disa dhjetëra kërkesave për procedim, nuk është specifike për periudhën tonë, por e vendos në kontekst atë që shohim: një pjesë dërmuese e ankesave filtrohet që në fazat e para, ose sepse nuk plotësojnë kushtet ligjore, ose sepse lidhen me vendimmarrje gjyqësore që ILD nuk ka kompetencë ta rishikojë. Numëruesi publik nuk na jep shpërndarjen mujore as arsyet konkrete të arkivimit për periudhën tonë, dhe pa to nuk mund të themi me siguri nëse tri propozimet reflektojnë rigorozitet apo diçka tjetër. Por na jep bazë të mjaftueshme për të thënë se volumi i ulët i propozimeve formale nuk është, në vetvete, tregues problematike, është pjesë e një modeli filtrimi që duket i qëndrueshëm ndër vite mbështetur edhe nga raportet e Bashkimit Evropian.

III. VENDIMMARRJA E SPAK-UT

Pasqyra e përgjithshme

Gjatë periudhës prill – korrik 2026, SPAK ka regjistruar 19 subjekte: 18 të dërguar për gjykim (94,7%) dhe një ndaj të cilit është zbatuar sekuestro pasurie në kuadër të hetimit në vijim (5,3%). Krahasuar me 30 subjektet e regjistruara për periudhën paraardhëse, intensiteti mesatar mujor bie nga 5,02 në 4,74 subjekte, pra me vetëm 5,5%, dallimi më i vogël midis të gjashtë institucioneve të monitoruara dhe, praktikisht, një veprimtari e pandryshuar.

Shkalla e subjekteve të dërguar për gjykim rritet nga 83,3% në periudhën e parë në 94,7% në këtë periudhë, çka tregon se pesha e masave të ndërmjetme, hetim në vijim, masa sigurie pa dërgim për gjykim, është zvogëluar dhe se hetimet mbërrin më shpesh te faza përfundimtare.

Përqendrimi është ekstrem: 78,9% e të gjithë subjekteve të periudhës burojnë nga një çështje e vetme, e përfunduar më 19 qershor 2026. Ky fakt ka rëndësi metodologjike të drejtpërdrejtë. Numri i subjekteve nuk mat volumin e punës hetimore, por momentin e ecursisë të hetimeve me natyrë komplekse. Një muaj me zero subjekte, si korriku, nuk tregon mungesë veprimtarie; ai tregon vetëm se asnjë hetim nuk ka arritur fazën e përfundimit brenda atij muaji. Për këtë arsye, seritë kohore të SPAK-ut duhen lexuar me hapa gjashtëmujorë.

Analiza sipas veprës penale

Ndryshimi kryesor kundrejt periudhës së parë matet tani me saktësi mbi bazën e njëjtë numërimi. Shkelja e barazisë në tendera kalon nga 36,7% në 57,9% dhe shpërdorimi i detyrës nga 20,0% në 47,4%, ndërsa korrupsioni pasiv bie nga 23,3% në 10,5% dhe falsifikimi i dokumenteve shfaqet për herë të parë me 15,8%. Ky nuk është ndryshim thjesht statistikor, por ndryshim i modelit të korrupsionit që ndiqet penalisht.

Vepra penale	Subjekte	% e totalit
Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera (neni 258 K.P.)	11	57,9%
Shpërdorim i detyrës (neni 248 K.P.)	9	47,4%
Falsifikim i dokumenteve (neni 186 K.P.)	3	15,8%
Korrupsion pasiv	2	10,5%
Grup i strukturuar kriminal / narkotikë (nenet 283/a, 284, 333/a, 334 K.P.)	2	10,5%
Pastrim i produkteve të veprës penale	1	5,3%
Zbulim i akteve ose i të dhënave sekrete	1	5,3%

Tabela 2_Veprat penale të hetuara

Korrupsioni pasiv (nenet 259 e vijues të Kodit Penal) presupozon një marrëdhënie dyanëshe të provueshme: dhënie dhe marrje shpërblimi. Shkelja e barazisë në tendera (neni 258) nuk kërkon provimin e një shpërblimi; mjafton të provohet se autoriteti kontraktor ka favorizuar ose diskriminuar pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Kalimi nga e para te e dyta do të thotë se ndjekja penale ka kaluar nga prova e transaksionit te prova e procedurës. Ky tregon se nga ndjekja e favorizimit fokusi kalon nga individi te dokumentacioni i procedurës administrative.

Pesha e lartë e *bashkëpunimit* është karakteristikë e dytë e periudhës. Pothuajse të gjitha kualifikimet e çështjes së qershorit përmbajnë referimin te neni 25 i Kodit Penal (bashkëpunimi), çka do të thotë se akuza nuk ndërtohet mbi veprime individuale të shkëputura, por mbi një skemë të koordinuar që përfshin njësinë e prokurimit, komisionin e vlerësimit të ofertave dhe nivelin drejtues të dy institucioneve të ndryshme.

Analiza sipas kategorisë së subjektit dhe shpërndarjes gjeografike

Nga pikëpamja gjeografike, subjektet shpërndahen në katër qarqe: Tiranë 9 (47,4%), Korçë 8 (42,1%), Vlorë (Sarandë) 1 (5,3%) dhe Gjirokastrë 1 (5,3%). Përqendrimi në dy qarqe, që bashkë përbëjnë 89,5% të totalit, është pasojë e drejtpërdrejtë e strukturës së çështjes së prokurimeve, e cila lidh një autoritet qendror me seli në Tiranë me një bashki në qarkun e Korçës.

Kategoria	Subjekte	Pjesa (%)	Qarqe
Zyrtarë të pushtetit vendor (Bashkia Kolonjë)	8	42,1%	1

Kategoria	Subjekte	Pjesa (%)	Qarqe
Zyrtarë të administratës qendrore dhe agjencie (ARRSH, AKSHI)	8	42,1%	1
Punonjës të strukturave policore	3	15,8%	3
TOTALI	19	100%	4

Tabela 3_Kategoria institucionale e subjekteve

Krahasuar me periudhën e parë, vërehet një zhvendosje e nivelit hierarkik të subjekteve. Në tetor 2025 – mars 2026, çështjet me profil më të lartë prekën një kryetar bashkie të kryeqytetit, një ish-zëvendëskryeministre dhe ministre në detyrë me imunitet parlamentar, dhe një ish-zëvendëskryeministër. Në periudhën aktuale, niveli më i lartë i prekur është ai i drejtuesve të agjencie qendrore (ish-drejtor i përgjithshëm i ARRSH-së, ish-drejtoreshë e AKSHI-t) dhe i kryetarëve të bashkive të vogla. Kjo nuk tregon zbutje të qasjes, por një fazë tjetër të ciklit hetimor: çështjet e nivelit politik të hapura në periudhën e parë ndodhen tashmë në fazën gjyqësore, ndërsa hetimet e reja janë përqendruar në nivelin administrativ ku prodhohen vendimet e prokurimit.

Çështja ARRSH – Bashkia Kolonjë

Çështja e përfunduar më 19 qershor 2026 përfshin pesëmbëdhjetë subjekte të regjistruar në databazën e monitorimit, të shpërndarë midis Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Bashkisë Kolonjë, për shkelje në procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga këto dy institucione.

Natyra e akuzës është elementi më domethënës i çështjes. Ajo shpërndahet në tri shtresa funksionale të dallueshme:

- **Niveli drejtues (6 subjekte):** kryetar bashkie, ish-nënkryetare bashkie, ish-drejtor i përgjithshëm i ARRSH-së, ish-drejtor drejtorie, përgjegjës sektori dhe ish-specialiste — të akuzuar për shpërdorim detyre në bashkëpunim (nenet 248 dhe 25 K.P.).
- **Niveli i komisioneve dhe i njësive të prokurimit (6 subjekte):** specialistë dhe anëtarë komisionesh — të akuzuar për shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera në bashkëpunim (nenet 258 dhe 25 K.P.).
- **Niveli i dokumentacionit (3 subjekte):** punonjës bashkie — të akuzuar njëkohësisht për falsifikim dokumentesh (neni 186 K.P.) dhe për shkelje të barazisë në tendera, të dyja në bashkëpunim.

Kjo natyrë akuze pasqyron një logjikë hetimore që ndjek ciklin e plotë të prokurimit: vendimin drejtues për t'i dhënë rrugë procedurës, veprimin e komisionit që kryen favorizimin, dhe dokumentin e falsifikuar që e mbulon atë. Provimi i njërës shtresë përforcon provimin e tjetrës, sepse falsifikimi i dokumentit shërben si provë e drejtpërdrejtë e dashjes në shkeljen e barazisë, ndërsa përsëritja e favorizimit në disa procedura ndërton elementin e dashjes te niveli drejtues.

Nga pikëpamja e llogaridhënies vendore, çështja ka rëndësi të veçantë sepse dokumenton mekanizmin përmes të cilit një bashki e vogël dhe një agjenci qendrore ndërveprojnë në prokurimin e infrastrukturës rrugore. Sektori i rrugëve përfaqëson një nga zërat me vlerën më të lartë të investimit publik dhe njëkohësisht me shkallën më të lartë të vështirësisë në verifikimin e cilësisë së zbatimit.

Sekuestrimi i pasurive — çështja e AKSHI-t

Më 21 prill 2026, në kuadër të procedimit penal nr. 20/1 të vitit 2025, u sekuestruan pasuri në vlerën e mbi 40 milionë eurove, ndërsa ish-drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (M.K.) mbetet nën hetim për korrupsion pasiv, shkelje të barazisë në tendera publikë dhe pastrim të produkteve të veprës penale.

Rasti dallon nga të tjerat sepse është i vetmi ku instrumenti kryesor nuk është masa personale, por masa pasurore. Sekuestrimi preventiv ka natyrë të dyfishtë: siguron ekzekutimin e një konfiskimi të mundshëm në rast dënimi dhe njëkohësisht ndërpret menjëherë përfitimin nga vepra penale, pa pritur përfundimin e gjykimit. Në çështjet e korrupsionit të nivelit të lartë, ku procesi gjyqësor mund të zgjatë vite, kjo është shpesh masa me efektin real më të menjëhershëm.

Vlera e sekuestruar, mbi 40 milionë euro është, në vetvete, treguesi më domethënës sasior i të gjithë raportit. Ajo tregon se dëmi potencial i korrupsionit në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe të sistemeve shtetërore është i një madhësie krejt tjetër nga ai i rasteve të korrupsionit të drejtpërdrejtë të regjistruara nga AMP-ja, ku vlerat janë në nivelin e mijëra ose dhjetëra mijëra lekëve.

Cikli i plotë procedural: rasti I.H.

Rasti i ish oficerit të policisë gjyqësore (I.H.) është i vetmi në serinë e monitorimit që dokumenton të gjitha fazat e një çështjeje penale brenda periudhës së monitorimit.

Faza	Akti	Periudha e monitorimit
Nëntor 2025	Masë sigurie “arrest në burg”	Raporti I
07.05.2026	Dërgim për gjykim (procedimi penal nr. 49/3/1/2026)	Raporti II
30.07.2026	Dënim me 2 vjet e 8 muaj burgim (gjykim i shkurtuar) dhe 5 vjet ndalim i ushtrimit të funksioneve publike	Raporti II
≈ 9 muaj	Nga masa e sigurisë te vendimi i shkallës së parë	84 ditë nga dërgimi për gjykim te dënimi

Tabela 4_ Cikli procedural i rastit I.H.

Akuza konsistonte në shpërdorim detyre, zbulim të akteve ose të dhënave sekrete dhe korrupsion pasiv të funksionarëve të organeve të drejtësisë: subjekti i kishte zbuluar një personi nën hetim se ishte objekt përgjimi në një hetim për trafik ndërkombëtar kokaine të bazuar në komunikimet SkyECC.

Nga ky rast dalin tri konstatime:

1. **Efikasiteti procedural.** Tetëdhjetë e katër ditë nga dërgimi për gjykim te vendimi dënues, në kushtet e gjykimit të shkurtuar, është një afat i shkurtër dhe bën kontrast të madh me situatën e evidentuar në raportin e mëparshëm, ku seancat në një çështje të profilit të lartë shtyheshin në mënyrë të përsëritur. Kjo tregon se problemi i zvarritjes nuk është uniform, por ndoshta i lidhur me kompleksitetin dhe ndoshta me profilin politik të çështjes.

2. **Dënimi plotësues.** Ndalimi i ushtrimit të funksioneve publike për pesë vjet ka rëndësi më të madhe se vetë dënimi me burgim, sepse është masa e vetme që parandalon rikthimin e subjektit në një funksion publik pas vuajtjes së dënimit. Në çështjet e korrupsionit të funksionarëve, ky dënim plotësues është instrumenti kryesor i mbrojtjes së integritetit institucional.
3. **Vlera e monitorimit të vazhdueshëm.** Rasti do të kishte mbetur i regjistruar si “*masë sigurie*” nëse monitorimi do të ishte ndërprerë me raportin e parë. Vetëm vazhdimësia e monitorimit na lejon matjen e rezultatit real.

Vlerësim përmblledhës

SPAK mbetet institucioni me luhatjen më të vogël të intensitetit, 5,5%, pra praktikisht i pandryshuar dhe me profilin operativ më të qëndrueshëm. Ndryshimi kryesor i periudhës është kalimi nga ndjekja e korrupsionit të nivelit politik te ndjekja e mekanizmave administrativë që prodhojnë korrupsionin, nga individit te procedura. Ky kalim është juridikisht më i vështirë, sepse kërkon provimin e një skeme të koordinuar në vend të një transaksioni të vetëm, por ka potencial parandalues më të madh, sepse godet vetë strukturën që mundëson shkeljen.

IV. VENDIMMARRJA E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

Ndryshimi i natyrës së veprimtarisë

Gjatë periudhës prill – korrik 2026, Kolegji i Posaçëm i Apelit publikoi 23 vendime, të cilat të gjitha kanë të njëjtin objekt: kërkesa për rishikimin e vendimeve të formës së prerë të vetë KPA-së. Asnjë nga këto vendime nuk është vendim apeli mbi një vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në periudhën tetor 2025 – mars 2026, KPA prodhoi 54 vendime apeli me natyrë substanciale, nga të cilat 30 shkarkime dhe 24 konfirmime ose rikthime në detyrë. Në periudhën aktuale, veprimtaria e monitoruar përbëhet tërësisht nga një mjet i jashtëzakonshëm ankimor. Kalimi nga funksioni i apelit te funksioni i rishikimit tregon se faza e zakonshme e ciklit të rivlerësimit kalimtar është praktikisht e shteruar dhe se institucioni ka hyrë në një fazë tjetër të *vettingut*: administrimi i kërkesave për rihapje të çështjeve të mbyllura vite më parë.

Transparenca e dispozitivit dhe vonesa e publikimit

a) Verifikueshmëria e rezultatit

Nga 23 vendimet, vetëm dy (8,7%) kanë një dispozitiv të konfirmuar përmes njoftimi zyrtar ose formulimi të qartë të verifikueshëm, të dyja me përfundimin “*mospranim i kërkesës për rishikim*”. Për 21 vendimet e tjera (91,3%), rezultati përfundimtar nuk mund të konstatohet pa lexuar tekstin e plotë të secilit vendim.

Kjo nuk përbën mungesë transparence në kuptimin klasik: aktet janë publikuar të plota dhe të anonimizuara, çka është standard i lartë. Problemi është i një natyre tjetër dhe shpesh i nënvlerësuar: *publikimi i aktit të plotë pa një njoftim përmblledhës të dispozitivit e bën informacionin të aksesueshëm por jo të monitorueshëm*. Për qytetarin, gazetarin ose monitoruesin e pavarur, dallimi midis një dokumenti prej dhjetëra faqesh dhe një fjalie që përmblledh rezultatin është dallimi midis transparencës formale dhe llogaridhënies reale. Rekomandimi që rrjedh është i thjeshtë dhe pa kosto: publikimi i njëkohshëm i një njoftimi standard me numrin, datën, objektin dhe dispozitivin e çdo vendimi.

b) Vonesa e publikimit

Njëzet e dy nga 23 vendimet janë marrë më 10–24 mars 2026, por janë bërë publike vetëm në maj–qershor 2026, sipas datave të arkivimit të akteve. Vonesa është, pra, rreth dy deri në tre muaj. Ky konstatim ka dy pasoja.

- E para është metodologjike dhe u trajtua në kapitullin III: çdo matje e volumit institucional në fund të një periudhe monitorimi është strukturalisht e nënvlerësuar, dhe rënia prej 18% e regjistruar për këtë periudhë duhet lexuar si kufi i sipërm.
- E dyta është juridike: vonesa e publikimit prek llogaridhënien në kohë reale dhe, në rastin e vendimeve që prekin statusin e magjistratëve, edhe interesin e vetë subjekteve për siguri juridike.

Mendimet paralele dhe mendimi i pakicës

Nga 23 vendimet e publikuara, 19 (82,6%) shoqërohen me mendime paralele të bashkëlidhura dhe, prej tyre, gjashtë (26,1% e totalit) përmbajnë gjithashtu një mendim pakice. Vetëm katër vendime (17,4%) janë publikuar pa asnjë opinion të bashkëlidhur.

Konfigurimi	Vendime	Pjesa (%)
Me mendime paralele, pa mendim pakice	13	56,5%
Me mendime paralele dhe me mendim pakice	6	26,1%
Pa opinione të bashkëlidhura	4	17,4%
TOTALI	23	100%

Tabela 5_Opinionet e bashkëlidhura të vendimet e KPA-së

Këto shifra kanë vlerë interpretuese të konsiderueshme. Një shkallë prej 82,6% e vendimeve me mendime paralele nuk është normale për një trup gjykues që zbaton një standard të konsoliduar. Ajo tregon se instituti i rishikimit të vendimeve të formës së prerë të KPA-së nuk ka ende një praktikë të unifikuar dhe se gjyqtarët e Kolegjit dallojnë ndjeshëm në arsyetimin që i çon te i njëjti dispozitiv, ose në vetë dispozitivin kur shfaqet mendimi i pakicës. Ky element përforcon konstatimin e pikës 9.2: kemi të bëjmë me një institucion procedural në formim e sipër. Mendimet paralele dhe të pakicës janë, në këtë fazë, jo shenjë dobësie por burimi kryesor nga i cili do të formohet standardi i ardhshëm.

Analiza juridike e institutit të rishikimit

Rishikimi i një vendimi të formës së prerë përbën, në çdo sistem juridik, një përjashtim nga parimi i *res judicata*. Ai justifikohet vetëm kur ekziston një interes më i lartë se stabiliteti i vendimit, kur konstatohet një shkelje e rëndë e procesit të rregullt ligjor ose kur dalin fakte të reja që nuk kishin mundur të merreshin parasysh.

Në rastin e *vettingut*, ky përjashtim ka një peshë të veçantë. Rivlerësimi kalimtar është parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës si proces me karakter të përkohshëm dhe të jashtëzakonshëm, i ndërtuar mbi një ekuilibër delikat midis interesit publik për pastrimin e sistemit të drejtësisë dhe të drejtave individuale të subjekteve të rivlerësimit. Prandaj, çdo mekanizëm që lejon rihapjen e vendimeve

përfundimtare të këtij procesi prek njëkohësisht dy vlera kushtetuese në tension: sigurinë juridike të rezultateve të reformës dhe të drejtën për një proces të rregullt.

Të dhënat e kësaj periudhe nuk lejojnë një vlerësim përfundimtar mbi mënyrën se si Kolegji e ka zgjidhur këtë tension, pikërisht sepse dispozitivi i 91,3% të vendimeve nuk është i verifikueshëm nga burimet publike përmbledhëse. Ajo që mund të konstatohet me siguri është se: në të dy rastet ku rezultati është i verifikuar, kërkesa nuk është pranuar dhe vendimi i mëparshëm ka mbetur në fuqi. Kjo sugjeron një qasje kufizuese ndaj institutit të rishikimit, në përputhje me natyrën e tij si mjet i jashtëzakonshëm, edhe pse dy raste nuk mjaftojnë për të nxjerrë një konkluzion.

V. GJETJET KRYESORE

Analiza e të dhënave nga tre institucionet e monitoruara gjatë periudhës prill – gusht 2026 prodhon katër gjetje kryesore:

- I. **Modeli i përgjegjësisë kaloi nga veprimi individual te bashkëpunimi dhe përgjegjësia e zinxhirit.** Te SPAK, pothuajse të gjitha kualifikimet e çështjes kryesore përmbajnë referimin te bashkëpunimi (neni 25 K.P.). Ky model kërkon standard prove dukshëm më kompleks, por është i vetmi që lejon ngjitjen e përgjegjësisë nga niveli ekzekutiv te niveli drejtues.
- II. **Kontrolli gjyqësor funksionoi si korrektiv efektiv i filtrit disiplinor.** Rasti A.K. dokumenton për herë të parë ciklin e plotë: propozim i ILD-së, rrëzim nga Këshilli, ankim gjyqësor, pranim i padisë nga Gjykata Administrative e Apelit, rishqyrtim i detyruar dhe pranim përfundimtar. Kjo përmbys konkluzionin e periudhës së mëparshme sipas së cilës asnjë propozim i ILD-së nuk ishte pranuar plotësisht: shkalla e propozimeve që kanë prodhuar një masë disiplinore kalon nga 33,3% në 66,7%. Çmimi i korrektivit është koha: 294 ditë për të arritur te masa më e butë e parashikuar nga ligji.
- III. **KPA kaloi nga funksioni i apelit te funksioni i rishikimit.** Të 23 vendimet e periudhës kanë për objekt kërkesa për rishikimin e vendimeve të formës së prerë të vetë Kolegjit, me distancë mesatare 5,72 vjet nga vendimi i rishikuar. Asnjë vendim apeli substancial mbi rivlerësimin nuk është regjistruar. Kjo tregon se faza e zakonshme e ciklit të *vettingut* është praktikisht e shteruar. Shkalla prej 82,6% e vendimeve me mendime paralele tregon se instituti i rishikimit është ende në formim e sipër dhe pa praktikë të unifikuar.
- IV. **Vonesa e publikimit është problem autonom, i matshëm dhe i dokumentuar.** Njëzet e dy vendime të KPA-së të marra në mars 2026 u bënë publike vetëm në maj–qershor 2026. Ky është i pari dokumentim i vonesës së publikimit brenda periudhës së monitorimit dhe imponon një ndryshim interpretimi: rënia prej 18,0% e intensitetit të përgjithshëm duhet lexuar si kufi i sipërm i rënies reale dhe, ndoshta, më shumë si problem transparence sesa si problem performance. Paralelisht, publikimi i akteve të plota pa njoftim përmbledhës të dispozitivit e bën informacionin të aksesueshëm por jo të monitorueshëm: vetëm 8,7% e vendimeve të KPA-së kanë rezultat të verifikueshëm pa lexim individual.

VI. KONKLUZIONE

Gjatë periudhës prill – gusht 2026, volumi i akteve të monitoruara ra me 18,0% në terma të intensitetit mesatar mujor; megjithatë, ky raport arrin në përfundimin se shifra mat kryesisht atë që u bë publike dhe jo domosdoshmërisht atë që u krye.

Ndryshimi i vërtetë i periudhës është cilësor. Sistemi i kontrollit mbi integritetin publik ka zhvendosur fokusin nga sjellja individuale të administrimit të burimeve dhe të territorit. Kjo zhvendosje nuk është neutrale. Ajo do të thotë se organet hetimore po ndjekin një model përgjegjësie më të vështirë për t'u provuar — mosveprimin, bashkëpunimin, zinxhirin komandues — dhe se po e lëvizin fokusin nga punonjësi në kontakt me qytetarin të niveli që prodhon vendimin. Rast i veçantë nga monitorimi i SPAK është prokurimi publik në infrastrukturë: një çështje e vetme prodhoi 78,9% të subjekteve të SPAK-ut në këtë periudhë, me një akuzë të ndërtuar në tri shtresa që mbulojnë ciklin e plotë të procedurës, nga vendimi drejtues të dokumenti i falsifikuar. Në terma të efektit parandalues, kjo është një zhvendosje me potencial dukshëm më të lartë, sepse godet strukturën që mundëson shkeljen dhe jo vetëm manifestimin e saj.

Në planin institucional, gjetja me vlerën më të madhe afatgjatë është rasti disiplinor i ILD-së. Ai dëshmon se arkitektura e ngritur nga reforma në drejtësi ka një mekanizëm vetëkorrigjues funksional: refuzimi i një propozimi disiplinor nga Këshilli nuk është fjala e fundit, ILD ka legjitimitet aktiv për ta kundërshtuar në gjykatë, dhe gjykata administrative mund ta detyrojë Këshillin ta rishqyrtojë. Ky është, në thelb, testi më i mirë i pavarësisë funksionale të ILD-së i regjistruar në të dyja periudhat e monitorimit. Çmimi, dhjetë muaj për një vërejtje publike, tregon njëkohësisht se mekanizmi funksionon, por me një kosto kohore që dobëson efektin e tij parandalues.

Në tërësi, të dhënat e periudhës prill – gusht 2026 dëshmojnë se mekanizmat institucionalë të kontrollit vazhdojnë të funksionojnë dhe, në disa aspekte, kanë kaluar në një fazë më të avancuar teknike. SPAK ruan një volum praktikisht të pandryshuar dhe ka kaluar nga ndjekja e individit të ndjekja e procedurës, me shkallën e subjekteve të dërguar për gjykim që rritet nga 83,3% në 94,7%; ILD ka provuar aftësinë për të mbrojtur me sukses propozimet e veta përpara gjykatës; KPA ka hyrë në fazën e administrimit të pasojave afatgjata të *vettingut*.

VII. REKOMANDIME

- I. **Për KPA: njoftim standard i dispozitivit.** Vetëm 8,7% e vendimeve të periudhës kanë rezultat të verifikueshëm pa lexim individual. Rekomandohet publikimi i njëkohshëm i një njoftimi të shkurtër me numrin, datën, objektin dhe dispozitivin e çdo vendimi. Masa nuk ka kosto dhe e shndërron transparencën formale në llogaridhënie të monitorueshme.
- II. **Për KPA: reduktimi i vonesës së publikimit.** Vonesa prej dy deri në tre muajsh midis dhënies dhe publikimit të vendimeve prek llogaridhënien në kohë reale dhe sigurinë juridike të subjekteve. Rekomandohet përcaktimi dhe publikimi i një afati maksimal institucional për publikimin.
- III. **Për ILD dhe Këshillat: shkurtimi i ciklit disiplinor.** Dhjetë muaj nga refuzimi të pranimi përfundimtar, për masën më të butë disiplinore, është afat që dobëson efektin parandalues. Rekomandohet analiza e afateve procedurale në ciklin propozim–vendim–ankim gjyqësor–rishqyrtim dhe identifikimi i hallkave me vonesën më të madhe.